

PËLLUMB XHUFI

VENEDIKU DHE SKËNDERBEU, NË LUFTË E NË PAQE

Vështirësitë në interpretimin e fakteve që lidhen me historinë e Gjergj Kastriotit, në përgjithësi, e me marrëdhëniet e tij të jashtme, në veçanti, burojnë në një masë të madhe nga vlerësimi ende jo proporcional që u është bërë shpesh burimeve tregimtare dhe atyre arkivore. Në mënyrë të posaçme, marrëdhëniet e Skënderbeut me Republikën e Venedikut, që janë tema e këtij punimi, nuk do mund të ndërtoheshin veçse në mënyrë të mangët e shpeshherë të gabuar, në rast se do mbivlerësoheshin të parat e nënvleftësoheshin të dytat. Nga koha kur F. Noli e A. Gegaj shkruanin veprat e tyre të merituarra për Gjergj Kastriotin, fondi dokumentar për Skënderbeun dhe epokën e tij është pasuruar mjaft, dhe siç e tregojnë studimet më të fundit të F. Pall, C. Marinesco, F. Cerone e sidomos K. Frashëri, O. J. Schmitt e A. Plasari, mbi historinë e Skënderbeut ka ende shumë për t'u thënë, e madje edhe për t'u korrigjuar¹. Por ndodh shpesh, që keqinterpretimet që i bëhen historisë së Skënderbeut e të epokës së tij, burojnë ndonjëherë nga një premisë metodologjike sipas nesh e gabuar, që e izolon atë histori nga konteksti i përgjithshëm i historisë mesjetare shqiptare dhe e trajton si një “fenomen” jetëshkurtër e të shkëputur, pa lidhje me proceset historike të mëparshme.

¹ Fan S. Noli, “Gjergj Kastrioti Skënderbeu (1405-1468)”, në Fan Noli, *Vepra* 4, Tiranë: Akademia e Shkencave të Shqipërisë, 1989; Athanase Gegaj, *L'Albanie et l'invasion turque au XV^{ème} siècle*, Louvain: Université de Louvain, 1937; Francesco Cerone, “La politica orientale di Alfonso di Aragona”, *Archivio Storico per le Province Napoletane* XXVII, 1902, f. 3-93; Constantin Marinesco, *Alphonse V, roi d'Aragon et de Naples, et l'Albanie de Scanderbeg*, Paris: Mélanges de l'Ecole Roumaine en France, 1923; F. Pall, “I rapporti Italo-Albanesi intorno alla metà del sec. XV”, estratto da: *Archivio Storico per le Province Napoletane* terza serie, IV, 1965, Società Napoletana di Storia Patria, Napoli: 1966; Kristo Frashëri, *Skënderbeu. Jeta dhe Vepra*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: Toena, 2002; Oliver J. Schmitt, *Skënderbeu*, përkryer nga Ardian Klosi, Tiranë: K&B, 2008; Aurel Plasari, *Skënderbeu. Një histori politike*, Tiranë: Gjergj Fishta, 2009.

Në fakt, shqiptarët e kishin përjetuar “epokën e Skënderbeut” edhe në fazat më të hershme të historisë së tyre. Qëkurse burimet e para bizantine flasin në mënyrë eksplicite për shqiptarët, në shek. XI, historia e tyre është një vazhdë kryengritjesh e përpjekjesh për shkëputje e për një organizim politik autonom nga Perandoria Bizantine². Krijimi i Principatës së Arbrit, në fund të shek. XII, është një gur kilometrik i rëndësishëm në këtë proces³.

Gjithsesi, më afër periudhës që na intereson këtu, asaj të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, janë formacionet shtetërore që u zhvilluan në Shqipëri në gjysmën e dytë të shek. XIV, ku më i fuqishmi ishte ai i vëllezërve Balsha. Shteti i tyre në zenitin e vet u shtri nga Budva, në veri, deri në Vlorë e Berat, në jug⁴. Brenda vitit 1372, Peja, Prizreni e hapësira deri në Novobërdë, kishin hyrë në zotërim të Balshajve⁵. Krushqitë e aleancat e ndryshme e zgjeruan ndikimin e Balshajve edhe në zotërimet e Topiajve, në Shqipërinë e Mesme, apo në Shqipërinë e Poshtme⁶. Po ashtu, nëpërmjet Andrea Gropës, vasal i tyre, ndikimi i Balshajve zbriste në fashën midis Dibrës e Ohrit e dilte në Kostur, qytet që vjehri i

² Alfred Rambaud, *L'Empire grec au X^{ème} siècle*, Paris: 1870, f. 261-262; F. S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu (1405-1468) ...*, f. 222-223; Aleks Buda, “Mittelalterliche Staatenbildungen in Albanien”, në *Studia Albanica*, 2, Tiranë: 1986, f. 3-14; Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbërit*, Tiranë: Pegi, 2006, f. 52-58, 75-88.

³ A. V. Soloviev, “Eine Urkunde des Panhypersebastos Demetrios, Megas Archon von Albanien”, në *Byzantinische Zeitschrift* 34, München: 1934, f. 304-310; P. Xhufi, *Dilemat e Arbërit ...*, f. 75-88.

⁴ “*per Juram de Balsce dominum Avalonae, Buduae et aliorum locorum*”, shih: *Acta et Diplomata Res Albaniae Mediae Aetatis Illustrantia* (më tej: *Acta Albaniae*), botues L. Thalloczy, C. Jireček, M. Šufflay, vol. II, Wien: Adolph Holzhausen, 1918, nr. 288.

⁵ Prizreni përmendet si zotërim i Gjergj Balshës në një dokument të 10 shtatorit 1372: “*determinatum fuit quod coracias IIII, que fuerunt donate Jure de Balsa, valloris librarum V de argento coracia siue panceria, per mercatores in Prisreno, quando dictus Jura cepit castrum dicti loci*”. Shih: *Acta Albaniae*, II, 322 (shënimet); Giuseppe Gelcich, *La Zedda e la dinastia dei Balscidi*, Spalato: Tipografia Sociale Spalatina, 1899, f. 84, 86; C. Jireček, “Srpski car Uroš, kralj Vukašin i Dubrovčane”, në “Zbornik Konstatina Jirečeka”, vëll. II, Beograd: 1959, f. 378-379, shën. 111; *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2002, f. 303-304.

⁶ Mavro Orbini, *Il regno de li Slavi*, Pesaro: G. Concordia, 1601, f. 289-290; Giovanni Musachi, “Breve Memoria de li discendenti de nostra casa Musachi”, në Carl Hopf, *Chroniques gréco-romanes, inédites ou peu connues*, Berlin: Weidmann, 1873, f. 298.

Balshës II, Andrea Muzaka, ia kishte rrëmbyer kralit serb, Vukashin më 1371⁷.

Një hapësirë të tillë sundimi e ndikimi, Skënderbeu nuk e arriti dot në 25 vjetët e epopesë së tij⁸. Ndërsa Balshajt zotëronin qytete të rëndësishme të hapësirës shqiptare, si Shkodrën, Drishtin, Ulqinin, Tivarin, Budvën, Prizrenin, Pejën, Novobërdën, Vlorën, Beratin e prej 1384-ës edhe Durrësin⁹, Skënderbeu përveç ndonjë qyteti të brendësisë, nuk mundi të ketë asnjërën prej qendrave të rëndësishme të bregdetit. Kur ai u kthye në Shqipëri, ato kishin hyrë nën sundimin e Republikës së Venedikut. Kështu, hapësira në të cilën u detyrua të lëvizte Skënderbeu, ishte më shumë një hapësirë veprimi, se sa hapësirë sundimi¹⁰. Qytetet si Durrësi, Shkodra, Lezha, Vlora, Berati, Ulqini, Tivari, ku pulsonte jeta ekonomike e tregtia e ku realizoheshin lidhjet me jashtë, mbetën deri në fund jashtë shtetit të tij dhe dalja në det në portin e vogël të Shufadasë, realizuar që në kohën e të jatit, Gjon Kastriotit, ishte shumë pak për realizimin e projektit të tij madhor për një unitet shtetëror funksional¹¹. Përjashtimi nga çdo e drejtë mbi qendrat e zhvilluara qytetare përbënte edhe thelbin e konfliktit të ashpër që shpërtheu mes Skënderbeut e Venedikut më 1448, ku çështja për trashëgimin e Danjës ishte vetëm detonatori¹². Nisur nga ai rast, Skënderbeu tentoi të dalë nga rrethi mbytës ku e kishte detyruar të mbyllej shtetin e tij Republika e Venedikut. Kështu, në muajin maj 1448, qyteti i Durrësit ishte vënë nën

⁷ “*Et in detta impresa invocò in suo ajuto il Rè Balsa suo genero, ch’hebbe per moglie la Signora Comita Mosachi sua figlia prima genita, et invocò anco in suo ajuto l’altro suo gennero nominato Signor Groppa Signor della città d’Ocrida gionto con un gran paese qual tutto era il suo*”, shih: G. Musachi, “Breve Memoria...”, f. 281.

⁸ Mbi shtrirjen e shtetit të Skënderbeut, shih: K. Frashëri, *Skënderbeu, jeta dhe vepra ...*, f. 181-182.

⁹ Alain Ducellier, *La façade maritime de l’Albanie au Moyen Âge. Durazzo et Valona du XI^e au XV^e siècle*, Tessaloniki: Institute for Balkan Studies, 1981, f. 490.

¹⁰ O. J. Schmitt, *Skënderbeu ...*, f. 170.

¹¹ A. Ducellier, “La façade maritime de la principauté des Kastriote de la fin du XIV^e siècle à la mort de Skanderbeg”, në *Deuxième Conférence des Etudes Albanologiques*, Tirana, 12-18 janvier 1968, vol. I, Tirana: Université de Tirana, 1969, f. 143-195.

¹² Një dokument venecian i 27 qershorit 1448 bën të ditur se në atë kohë Skënderbeu e kishte marrë Danjën (*sed tenente dicto Scandarbego Dagnum, sicut dicitur, quod tenet*), S. Ljubić, *Listine o odnošajih izmezdju ...*, vëll. IX, f. 269-273, 27 Junii 1448; Jovan Radonić, *Djuradj Kastriot Skenderbeg i Arbanija u XV veku*, Srpska Kraljevska Akademija. Spomenik XCV, Beograd: Mlada Srbija, 1942, f. 10.

goditjet e Kastriotit e rrezikonte të binte në duart e tij¹³. Senati nxitoi atëherë të dërgojë drejt qytetit ndihma e përforcime ushtarake, ndërsa një ambasador u dërgua tek Sulltani “për të kërkuar ndëshkimin e Skënderbeut”¹⁴.

Por, nuk kaluan veç dy muaj, dhe konflikti u zhvendos në një skenar tjetër. Në korrik të vitit 1448, qeveritari venecian i Tivarit, Giacomo Dolfin, njoftonte Senatin, se “Skënderbeu me një ushtri të madhe prej 10 mijë ushtarësh, së cilës i ishin bashkuar edhe burrat e Malësisë, kishte sulmuar qytetin e Tivarit”. Por, sipas Dolfin, ushtria e Skënderbeut ishte thyer dhe në betejë mbetën 1600 ushtarë të vrarë e shumë robër. Qeveritari venecian ia atribuon këtë fitore të armëve veneciane faktit, që ai kishte arritur të bënte për vete Markoviçët, fqinjë me Tivarin, ndërsa fshatrat e tjera pranë qytetit ishin bashkuar me Skënderbeun. Veç kësaj, ai raporton se kishte arritur të mbillte armiqësinë midis Skënderbeut e

¹³ Autoritetet veneciane të Durrësit, i kërkuar me atë rast Senatit lejen për ta paqtuar Skënderbeun, duke i paguar atij një tribut prej 400 dukatësh e duke i dhuruar dy kostume në vit. Por Senati u përgjegj se “nuk ishte mirë që Skënderbeu të paqtohej në këtë mënyrë me Durrësin, ndërkohë që me qytetet e tjera veneciane ishte në gjendje lufte”. Megjithatë qetësoheshin qeveritarët e Durrësit, duke u dhënë lajmin se “shumë shpejt do të bëjmë disa lëvizje, që do sjellin paqen e qetësinë në të gjithë atë provincë”. Është e qartë, se me këto “lëvizje” Senati i Venedikut kuptonte traktativat që kishte nisur ndërkohë me turqit për të sulmuar Skënderbeun, si dhe kontaktet e vendosura me dukagjinët e krerët e tjerë shqiptarë, anëtarë të Lidhjes së Lezhës, për t’i shkëputur ata nga Kastrioti (*Ad id autem quod petunt posse facere concordium cum dicto Scandarbego pro ducatis III C. et duabus vestibus in anno, Respondeatur eis, quod non videtur nobis esse bonum, quod dictus Scandarbego haberet securitatem et pacem, cum una nostrarum civitatum, et cum aliis guerram, et quod presto fient tales provisiones in illis partibus, quod omnis illa provincia in pace conservabitur*). *Acta Albaniae Veneta* (më tej: AAV), pars III, tom 20, München: Rudolf Trofenik, 1974, nr. 5347, f. 6-7: 22 shkurt 1448.

¹⁴ Ambasadori venecian duhej të hiqej sikur nuk e dinte që Skënderbeu ishte shkëputur nga Sulltani dhe ishte në luftë me të, ndaj duhej t’i kërkonte këtij që ta ndëshkonte prijësin shqiptar e të paguante dëmet e shkaktuara prej tij “pasi Skënderbeu është Turk dhe ne me Turkun jemi në paqe” (*et insuper quia Scandarbego est Turchus, et nos cum Turcho habemus bonam pacem vigore cuius talia attentare dictus Scandarbego non poterat nec debebat misimus ad dictum dominium Turchorum nostrum nuncium ad petendum punitionem Scandarbego predicti, et emendationem dannorum per ipsum datorum*), shih: AAV, pars III, tom 20, nr. 5361, f. 17-19.

Stefan Gjurashit (Cërnojeviç), kunat i tij e anëtar i Lidhjes së Lezhës, “duke i nxitur të përlesheshin e të vriteshin mes vedit”¹⁵.

Mbjellja e përçarjes dhe e konflikteve midis Skënderbeut dhe aleatëve të tij, ishte një nga drejtimet kryesore të politikës së Venedikut, dhe një nga faktorët që më së shumti minonte kohezionin dhe forcën e shtetit të Skënderbeut. Hegjemonia e saj mbi qytetet bregdetare shqiptare nuk mund të ruhej, në rast se në hinterlandin e tyre do sundonte një princ i vetëm¹⁶. Në këtë vështrim, në shkurt të vitit 1448, Senati i Venedikut urdhëronte të dërgoheshin dy emisarë, njëri tek despoti serb Gjergj Brankoviç dhe tjetri tek dukagjinët, për t'i nxitur këta kundër Skënderbeut¹⁷. Në këtë drejtim, të dërguarit venecianë punuan deri edhe me kërret e vegjël të fshatrave, siç ishte Progon Begani, pronjar i Balldrenit, që pak kohë më parë kishte ngritur krye kundër Sinjorisë dhe ishte bashkuar me Skënderbeun (*rebellavit nostro dominio, et adhesit Scandarbego*). Megjithatë, tani venecianët përpiqeshin ta joshnin të shkëputej prej tij, duke i premtuar t'i kthenin pronat¹⁸. Por, disa muaj më vonë gjendja e zotërimeve veneciane në Shqipëri ishte bërë edhe më kritike, dhe në qershor 1448 Senati dërgoi aty një ambasador me mision të trefishtë. Së pari, ai duhej të bindte turqit osmanë, duke u plotësuar edhe çdo kërkesë, që këta më në fund “të vinin me ushtri në Shqipëri për ta shpartalluar Skënderbeun e rrezikshëm, në mënyrë që prej tij mos të mbetej shenjë jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë botën (*ut dicte gentes Teucrici cito conducantur in paisium Albanie ad ruinam illius Scanderbeghi perfidi, et dari faciendo...illis gentibus Teucrici omnes favores possibiles, quibus mediantibus dictus Scandarbego non modo de*

¹⁵ “1448, luglio, scrive Giacomo Delfin da Antivari, che Scanderbeg con 10.000 uomini, uniti a quelli della Montagna, calò sopra Antivari, ma che fù rotto con morte de 1600 uomini e molti prigioni; che questa vittoria s'hebbe per il buon portamento di quelli Marcovich, che è una vallata su quel de Antivari, e che gli altri contadini sono ribelli. Giacomo Dolfin, podestà d'Antivari, non sapendo come vincere i nemici, pose sospetto tra Steffano Cernovich e Schanderbeg, detto l'Ottomano, con mezzo di lettere, per cui costoro tra loro s'azzuffarono e distrussero”. J. Radonić, *Djuradj Kastriot Skenderbeg ...*, f. 14.

¹⁶ A. Ducellier, *La façade maritime ...*, f. 649.

¹⁷ “quod mittatur ad despotum unus Ambaxiator, ad faciendum cum illo concordium, antequam faciat expensam gentium suarum, et veniat in Zentam, et similiter mittatur unus alius ambaxator vel nuntius ad partes Albanie, ad praticandum cum Duchainis, qui coniuncti sunt cum Scandarbego et ad faciendum cum illis concordium, ita ut ab illo Scandarbego separentur”, AAV, pars III, tom 20, nr. 5347, f. 6-7: 22 shkurt 1448.

¹⁸ AAV, pars III, tom 20, nr. 5365, f. 24: 7 qershor 1448:

Albania, sed de mundo ejiciatur). Por, nëse turqit do vazhdonin të vononin të sulmonin, ambasadori duhej të shkonte tek Skënderbeu “për të fituar kohë dhe për të qetësuar shpirtin e tij” (*ritardare et frigescere animum dicti Scandarbeghi*) duke i kujtuar miqësinë e hershme që Republika kishte patur me të jatin, Gjonin. Emisari venecian porositej t’i kërkonte Skënderbeut që të hiqte dorë nga sulmet dhe të jetonte në fqinjësi të mirë me Republikën “duke patur parasysh edhe të ardhmen, pasi gjërat nuk do qëndronin përjetësisht në gjendjen aktuale” (*considerare tempus futurum, quia res non semper in eodem statu permanent*). Pas këtij mesazhi paqeje dhe kërcënimi njëkohësisht, i dërguari venecian mund të hynte në bisedime lidhur me pretendimet që kishte Skënderbeu ndaj Venedikut. Duhej të dëgjonte kërkesat e tij, pa i premtuar gjë, “dhe duhet të mendohej t’i zgjaste bisedimet sa më shumë, deri sa t’i vinte lajmi se ushtritë turke i ishin afruar kufijve të Shqipërisë, dhe atëherë me fjalë e pretekste të ndryshme, duhet të largohej për në Shkodër” (*ducendo rem in tempus de die in diem, quousque gentes Teucrici versus Albaniam apropinquaverint et intraverint, quod quando certe scieris, debeas cum illis rationibus et verbis, que tibi videbuntur, ab illo Scandarbegho discedere et Scutarum redire*). Por, në rast se ushtria osmane nuk do të dukej, ambasadori venecian porositej “të nënshkruante paqen me çdo kusht, pasi e tillë ishte situata” (*quia propter conditionem presentis temporis volumus omnino, pacem facias*). Në rast se Skënderbeu do vazhdonte të refuzonte çdo ujdë, emisari venecian duhej të largohej dhe “pa ndihmën e të tretëve” të merrte kontakt me vëllezërit dukagjinë, Palin e Nikollën. Me anë të premtimeve për dhurim fshatrash e të hollash, duhet t’i shkëputte ata nga Skënderbeu e ti hidhte në krahun e Sinjorisë, e cila shumë më tepër se Skënderbeu do të kujdesej për ta, për fëmijët e tyre dhe për fëmijët e fëmijve të tyre” (*quod separentur ab ipso Scandarbeggo et velint esse nobiscum, qui sibi et suis filiis et filiis filiorum longiori tempore iuvare poterimus, quam ipse Scandarbeggo*). Ndarjes së dukagjinëve nga Skënderbeu, Venediku i jepte rëndësi të madhe: “pa Dukagjinët, Skënderbeu do të mbetej krejt i pafuqishëm përballë nesh dhe kështu do mund ta shpartallojmë lehtësisht (*sine Duchainis ipse Scandarbeggo erit valde impotentior nobis, et faciliter poterit destrui*). Në fund, ambasadori porositej të takonte edhe despotin

serb Gjergj Brankoviç e ta bindte edhe atë që t'i bashkohej Republikës në përpjekjet për shkatërrimin dhe asgjësimin e Skënderbeut¹⁹.

Në fakt, në muajin korrik Senati mori lajmin se ushtritë osmane kishin hyrë në Shqipëri për të sulmuar Skënderbeun, dhe ky u detyrua të hiqte rrethimin e qyteteve veneciane e të kujdesej për të mbrojtur “*shtetin e tij*” (*gentes Teucris descenderunt ad damna Scanderbeghi, ita quod derelictis locis nostris, ad defendendum statum suum accessit*)²⁰. Lajmi u prit me ngazëllim nga Senati, i cili kur mori vesh se kunati i Skënderbeut, Muzak Topia, përpiquej t'i shpëtonte furisë osmane duke kërkuar strehim në Durrësin venecian, urdhëroi qeveritarët e vet në Shqipëri “që Skënderbeut, Dukagjinëve, Muzak Topisë dhe të gjithë atyre krerëve e komandantëve të kështjellave që kishin ngritur krye kundër Sinjorisë, të mos u jepej strehë në qytetet veneciane, por të liheshin që të shuheshin me rrënjë e me degë”²¹. Nëse i shtojmë këtyre fakteve edhe tentativën ekstreme, që Republika e Venedikut bëri për ta eliminuar fizikisht Skënderbeun²², përftohet një kuadër krejt i zymtë i marrëdhënieve mes tyre. Ndonjë studiuës i marrëdhënieve të Skënderbeut me Republikën e Venedikut befasonet nga ky qëndrim armiqësor i Sinjorisë ndaj heroit shqiptar, ndërkohë që ajo duhet ta konsideronte atë si aleatin më të natyrshëm të saj²³.

¹⁹ S. Ljubić, *Listine o odnošajih ...*, vol. IX, f. 269-273: 27 Junii 1448: J. Radonić, *Djuradj Kastriot Skenderbeg ...*, f. 10.

²⁰ AAV, pars III, tom 20, nr. 5383, f. 45: 29 korrik 1448; J. Radonić, *Djuradj Kastriot Skenderbeg*, f. 13.

²¹ “*quod pariter cum Comite et Capitaneo Scutari procuretis ruinam Scanderbeghi predicti, et Duchainorum, et a latere vestro attenditis illorum destructionem, et hoc ipsum dicimus de Tobia cognato suo, et de aliis dominis et castellanis, qui rebelles fuerunt nostro dominio, ut nullo modo in terras vel loca nostra suscipiantur, sed destruantur radicitus*”, AAV, pars III, tom 20, nr. 5383, f. 45: 29 korrik 1448; J. Radonić, *Djuradj Kastriot Skenderbeg ...*, f. 13.

²² “*Cum quidam fidelis subditus noster, qui est persona bone reputationis et pratica et sagax, dici fecerit nostro dominio, quod haberet modum dandi vel dari faciendi mortem Scandarbergo inimico nostro, sed vult habere provisionem ducatorum C in anno; vadit pars, quod respondeatur sibi, quod si ipse dabit vel dari faciet mortem Scandarbergo predicto*”, ASV, pars III, tom 20, nr. 5357, f. 15: 4 maj 1448; S. Ljubić, *Listine o odnošajih izmezdju ...*, vëll. IX, Zagreb: Jugoslovenska Akademija Znanosti i Umjetnosti, 1890, f. 268.

²³ “*Come condottiero e come uomo di Stato il Castriota sapeva bene che Venezia stava peggio dell'Albania, e di conseguenza non riusciva a comprendere quella politica incerta di fronte alla situazione balcanica che precipitava di giorno in giorno, mentre la Rep. Veneta avrebbe dovuto essere il più naturale alleato dell'Albania*”, A. Serra,

Në fakt, përpara Skënderbeut, sjellja e Republikës së Venedikut kishte qenë e tillë edhe me sundimtarët Balshaj. Edhe kundër tyre, venecianët nuk ngurruan të thërrasin për ndihmë turqit osmanë²⁴. Por, nga dokumentacioni venecian del në sipërfaqe një urrejtje e egër dhe krejt e veçantë për Skënderbeun, që bie në sy edhe nga koloriti i epiteteve fyese që i rezervohen atij, përfshi edhe epitetin “Otomani”²⁵. “Venecianët thonë për Skënderbeun çdo gjë të keqe”, raportonte oratori i Milanos në Romë më 1467, “për shëmbull thonë se ai është më turk se turqit, dhe ndonjë prej këtyre venecianëve që ndodhen në oborrin e papës ka dashur madje të hapë fjalë se Skënderbeu ka ardhur këtu si informator e agjent i turkut”²⁶.

Kjo gjendje e marrëdhënieve mes Venedikut e Skënderbeut vlen sidomos për vitin 1448, viti i përplasjes më të egër midis Skënderbeut e Republikës Venete. Por, situata e krijuar për venecianët në Shqipëri pas disfatës së rëndë që ushtria e tyre pësoi më 23 korrik 1448 në betejën e Drinit²⁷, më tej pas shpartallimit të ushtrisë osmane të thirrur nga venecianët nga forcat e Skënderbeut në betejën e Oranikut, më 14 gusht të po atij viti²⁸, si dhe pas humbjes së disa lokaliteteve nën jurisdikcionin

“Relazioni del Castriota con il Papato nella lotta contro i Turchi (1444-1468)”, në *Archivio Storico Italiano* CXV/1, 1957, f. 33.

²⁴ Kështu, më 17 gusht të vitit 1419, Senati vendosi t'i blatojë turqve osmanë 5 mijë dukatë për t'i joshur ata të sulmonin Balshën, “armikun tonë” (*de mittendo ad partes Scutari ducatos quinque mille pro dando Teucris, qui venirent ad damna Balse inimici nostri*), S. Ljubić, *Listine o odnošajih između južnoga slaventstva i mletačke Republike*, vëll. VIII (1420-1424), Zagreb: Jugoslovenska Akademija Znanosti i Umjetnosti, 1886, f. 3.

²⁵ J. Radonić, *Djuradji Kastriot Skenderbeg ...*, f. 14. Këtë epitet venecianët ia atribuon vazhdimisht Skënderbeut, sidomos në vitin e konfliktit të egër mes tyre, 1448: “*quia Scandarbego est Turchus*”, “*Scandarbegho, Turchum et perfidum hominem*”, AAV, pars III, tom 20, nr. 5361, f. 17-19: 25 maj 1448; S. Ljubić, *Listine o odnošajih ...*, vëll. IX, f. 269-273: 27 Junii 1448; J. Radonić, *Djuradji Kastriot Skenderbeg ...*, f. 10.

²⁶ “*Intendemo versa vice che Venetiani dicono ogni male de dicto Scandarbecho, videlicet che l'è più Turco che li Turchi; et alcuni de quisti Venitiani che sono qua in corte hanno ancora voluto murmurare che l'è venuto qua per uno esploratore et spione del Turcho*”, Aurel Plasari, *Skënderbeu. Një histori politike*, Instituti i Studimeve Shqiptare “Gjergj Fishta”, Tiranë: 2010, f. 704.

²⁷ Giannaria Biemmi, *Istoria di Giorgio Castrioto detto Scander-Begh*, Brescia: G. Rizzardi, 1756², f. 110-122.

²⁸ Data është nxjerrë me shumë mprehtësi nga: F. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu ...*, f. 275, shën. 234.

e Danjës, pushtuar nga Pal Dukagjini²⁹, e dobësoi së tepërmi pozitën e Sinjorisë dhe Senati vendosi të kërkojë paqen me zotin e Arbërisë. Venediku nxitoi t'i japë fund luftimeve me Skënderbeun edhe për arsye se, në një kontekst më të gjerë, bashkëpunimi me turqit osmanë e kishte komprometuar rëndë pozitën e tij në marrëdhëniet me papatin dhe me botën e krishterë³⁰. Por, nga ana tjetër, zotërimet e tij në Shqipëri e Dalmaci po bëheshin objekt sulmesh gjithnjë e më të shpeshta nga ana e osmanëve. Territoret e Skënderbeut dhe të anëtarëve të tjerë të Lidhjes së Lezhës, ndodheshin në hapësirën që ndante bazat osmane në Maqedoni nga zotërimet veneciane në bregdetin Adriatik. Që të mbërrinin deri në qytetet veneciane të bregdetit, inkursionet osmane duhet të depërtonin nëpër zotërimet e krerëve shqiptarë. Në këtë mënyrë, qëndrimi i tyre kishte rëndësi vendimtare për të ardhmen e zotërimeve veneciane në Shqipëri. Jo më kot, vite më vonë, më 4 prill 1460, Senati i Venedikut porosiste qeveritarët e vet në Shqipëri, që ta mbanin mirë me Skënderbeun veçanërisht për shkak të turqve, “pasi Skënderbeu ishte i dobishëm ngaqë kontribuonte shumë për ruajtjen e zotërimeve tona në ato anë” (*eumque contentum tenere per ea que in illis partibus de Theucris sonant, cum Scanderbeghus ipse utilis et ad conservationem status nostri ipsarum partium plurimum conferat*)³¹.

Gjithashtu, në dorë të Skënderbeut e të aleatëve të tij ishte edhe hapja apo mbyllja e rrugëve tregtare që çonin drejt tregjeve të këtyre qyteteve, ku nga brendësitë e vendit silleshin kryesisht produkte ushqimore e ku blihej kripa e çmuar si dhe produkte të tjera të rafinuara veneciane. Aktiviteti tregtar ishte shumë fitimprurës për venecianët edhe në këtë skenar lufte, dhe jo më kot, në shtator 1458, Senati i thurte lavde dhe shpërblente me privilegje abatin e manastirit Shën Mëria e Rotecit (Tivar), Gjergj Pelinin, i cili si ambasador i Skënderbeut, kishte arritur ta bindte zotin e tij të hiqte dorë nga vendimi për të mbajtur të mbyllura të gjitha rrugëkalimet për Durrës e Lezhë³². Kështu, ndërsa i trembej

²⁹ J. Radonić, *Djuradj Kastriot Skenderbeg ...*, nr. 22, f. 16.

³⁰ Roberto Cessi, *Storia della Repubblica di Venezia*, vol. I, Milano: Principato, 1968, f. 403.

³¹ AAV, pars III, tom 24, nr. 6903, f. 156.

³² “*Cognovimus cum quanta fide et integritate, suam propriam facultatem exbursando procuraverit et sollicitaverit remove errors et inconvenientia habita cum Magn. domino Scanderbei qui omnes passus terre Durachii et Alexii clauserat*”, AAV, pars III, tom 23, nr. 6687, f. 354: 6 shtator 1458.

fuqizimit të Skënderbeut, Sinjoria paradoksalisht ishte edhe interesuar për mbijetesën e tij, por, siç vumë në dukje pak më parë, jo si zot i vetëm në Shqipëri³³.

Marrëveshja që duhet t'i jepte fund luftës midis Skënderbeut dhe Republikës së Venedikut u nënshkrua më 4 tetor 1448. Në fakt bëhej fjalë për një traktat të vërtetë paqeje. Disa nga kapitujt e saj trajtonin plagët që kishin lënë pas luftërat e fundit mes Sinjorisë dhe Lidhjes së komanduar nga Skënderbeu. Kështu, Republika e Venedikut zotohej t'i konsideronte "si fqinjë e miq të vërtetë e të dashur vetë Skënderbeun, Nikoll Dukagjinin e të gjithë zotërit e tjerë të Shqipërisë, duke i falur ata për fyerjet e dëmet që i kishin shkaktuar Sinjorisë". Më tej, si Sinjoria ashtu edhe Skënderbeu deklarorin se i amnistonin të gjithë ata shtetas të tyre, të cilët gjatë luftës kishin ngritur krye dhe ishin lidhur me palën kundërshtare. Ata mund të ktheheshin në shtëpitë e tyre pa patur frikë se do dënoheshin. Por, tash e tutje, shtetasit e Venedikut që do kryenin faje ndaj Republikës, nuk do mund të strehoheshin më në zotërimet e Kastriotit dhe e njëjta gjë do ndodhte me shtetasit e Skënderbeut që, për një faj ose tjetrin, do kërkonin të strehoheshin në zotërimet e Republikës. Nga ana e tyre, Skënderbeu dhe Nikollë Dukagjini zotoheshin ta bindnin Pal Dukagjinin, t'i kthente Venedikut fshatrat e fortesat pranë Danjës, që ai i kishte pushtuar pak kohë më parë. Nëse Pali nuk do të bindej, Skënderbeu dhe Nikolla premtonin se nuk do ndërhyenin në përplasjet që mund të lindnin midis Sinjorisë dhe Palit në fjalë.

Në marrëveshje nuk mund të mungonin edhe kapitujt që trajtojnë çështje ekonomike e tregtare. Skënderbeut i njihej e drejta të blinte në depot e Durrësit çdo vit 200 kuaj me kripë, të çliruar nga detyrimet doganore. Kurse Gjergj Arianiti do mund të blinte po në Durrës, pa paguar doganë, stofra të ndryshme për përdorim personal e të familjes së tij. Skënderbeu do merrte dhuratë nga Senati dy kostume të shtrenjta në vit, ndërkohë që ai vetë duhej t'i dhuronte Sinjorisë "në shenjë nderimi" (*dar de honoranza*) dy qen gjahu dhe një skifter. Një pikë e rëndësishme e marrëveshjes ishte ajo që e detyronte Sinjorinë t'i jepte Skënderbeut çdo vit një shumë prej 1400 dukatësh, e cila do fillonte të livrohej duke

³³ "che esso Scanderbago insieme cum quelli altri signoreti siano tenuti, cum ogni suo zente ala defension del paexe, et a tener le strade aperte da ogni violentia, si che le charavane si del loro paexe, chome de ogni altro liberamente possini vegnir ale terre e luogi nostri cum loro mercadantie, e a tuor el sal da le camere nostre", AAV, pars III, tom 20, nr. 5347, f. 6-7.

filluar nga data 26 tetor e atij viti, që ishte festa e Shën Dhimitrit³⁴. Një kapitull tjetër i marrëveshjes tregon se Skënderbeu për atë vit ngutej ta merrte shumën prej 1400 dukatësh edhe para datës 26 tetor. Aty thuhet shprehimisht, se “Sinjoria duhej t’i dorëzonte zotit Skënderbej jashtë radhe, brenda 15 ditëve, 1400 dukatë që do llogariteshin në provizionin e tij, pasi këshilli i krerëve të Shqipërisë kishte vendosur që vetë Skënderbeu të shkonte personalisht me ushtrinë që do mblidhte për t’iu bashkuar ushtrisë së Janit (Huniadit, P. Xh)”³⁵. Pra, kërkohej të bëhej një përjashtim për atë vit dhe provizioni venecian t’i dorëzohej Skënderbeut një javë para afatit të caktuar në marrëveshje, 26 tetori, dita e Shën Dhimitrit, në mënyrë që ai të përdorej në funksion të fushatës antiosmane të Jan Huniadit të Hungarisë, ku Skënderbeu dhe Lidhja e Lezhës kishin vendosur tashmë të merrnin pjesë.

Pak më sipër u përmend deklarata e bërë nga Senati, më 4 prill 1460, ku u tërhiqej vëmendja qeveritarëve venecianë të Shqipërisë që të mbanin marrëdhënie të mira me Skënderbeun, pasi ky kontribuonte shumë për mbrojtjen e zotërimeve veneciane. Deklarata u bë me rastin kur një dërgatë e Skënderbeut ishte paraqitur para Senatit për t’u ankuar për moslëvrimin e shumës prej 1400 dukatë që Sinjoria detyrohej t’i paguante heroit shqiptar në bazë të marrëveshjes së vitit 1448. Në fakt, kishin kaluar 12 vjet nga nënshkrimi i marrëveshjes, dhe në asnjë prej atyre viteve shuma në fjalë nuk ishte dorëzuar, as në kohë e as e plotë. Ankesave të përsëritura, venecianët u bënë gjithmonë bisht. Kur të dërguarit e Skënderbeut insistonin në kërkesën e tyre për të respektuar marrëveshjen, përfaqësuesit e Sinjorisë nuk mungonin të bënin përgjegjësis pikërisht Skënderbeun për moszbatimin e kësaj pike të marrëveshjes. “Zotëria e Tij ka një detyrim kundrejt nesh, që të kujdeset që karvanet dhe banorët e atyre anëve të detyrohen të vijnë në zotërimet tona për të

³⁴ J. Radonić, *Djuradj Kastriot Skenderbeg ...*, nr. 22, f. 15.

³⁵ “*Item perche fato el consiglio fra lor suprascripti i Signori de l’Albania, ha determinado, chel suprascripto Signor Scanderbego vadi personalmente cum quel più exercito el pora ad unirse cum el Signor Janus, che la prefata Signoria de Venexia debia far dar et consignar al prefato Signor Scanderbego sopra la sua provision, da mo fin a zorni XV, ducati mille quatrocento, da esser diffalcadi in la sua provision*”, J. Radonić, *Djuradj Kastriot Skenderbeg ...*, nr. 22, f. 15; ASV, pars III, tom 20, nr. 5396, f. 55-57.

blerë kripën tonë dhe për të shitur produktet e tyre; sepse duhet ta dijë që provizioni i tij del pikërisht nga këto shkëmbime”³⁶.

Çështja e mospagimit të provizionit vjetor nga ana e Venedikut, shqetësoi edhe Mbretin e Napolit, aleatin e, formalisht, sovranin e Skënderbeut³⁷. Më 5 mars 1453 Alfonsi V i shkruante dogjit të Venedikut, Francesco Foscari, për t’iu ankuar se “prej shumë vitesh Skënderbeut nuk po i lëvroheshin 1400 dukatet”. Por Mbreti Alfons shkon më tej, duke denoncuar edhe një shkelje tjetër që Venecianët i bënë marrëveshjes së nënshkruar më 1448 me Skënderbeun. “Ju”, shkruante ai plot stigmë, “ndihmoni dhe strehoni në qytetet tuaja renegatët dhe armiqtë e tjerë të tij, kundër të cilëve ai lufton në emër të fesë”³⁸. Nuk mjaftoi kjo, por pak para vitit 1456, me siguri pas disfatës së Skënderbeut në Berat, Venediku nënshkroi një paqe të re me Sulltanin. Një nen i saj shkelte një tjetër kapitull të marrëveshjes së Venedikut me Skënderbeun. Në fakt, Republika angazhohej përpara Sulltanit se “nuk do strehonte në territoret e veta armiqtë e tij”. Referimi ndaj Skënderbeut ishte i qartë dhe ky nuk nguroi të shprehë revoltën e tij. Prandaj, më 26 prill 1456, Senati porosi Proveditorin e ri të Durrësit, Francesco Venier, që t’i bënte një vizitë kortezie Skënderbeut, dhe nëse ky prekte çështjen e marrëveshjes së re turko-veneciane e të kapitullit që drejtohej kundër tij, Venier duhej “të gjente fjalët e arsyet e përshtatshme për ta justifikuar atë kapitull, si të mundte dhe si të dinte”(Si sua magnificentia aliquid tibi diceret de capitulo pacis ultimate concluse cum Teucro circa receptum non dandum in terris nostris hostibus suis, justificabis dictum capitulum cum convenientibus verbis et rationibus, sicut pro prudentia tua facere poteris et scies)³⁹.

³⁶ “sua Magnificentia erga nos etiam debet velle servare videlicet in providendo et ordinando quod caravane et homines illarum partium veniant ad accipiendum de sale nostro et ad conducendum de rebus et mercationibus suis ad terras et loca nostra, ex quibus sicut scit, suam provisionem habere debet”, AAV, pars III, tom 23, nr. 6295, f. 13-14: 13 mars 1455.

³⁷ Pëllumb Xhufi, “Ein gelobter Vasall: Skanderbeg und Alphons von Neapel”, në M. Genesin, J. Matzinger, G. Vallone (eds), në *The living Skanderbeg. The Albanian Hero between Myth and History*, Hamburg: Verlag Dr. Kovač, 2010, f. 245-258.

³⁸ “a superiore vero anno citra et de dictis 1400 ducatis ei solutum non fuisse et lucagenos ceterosque eius hostes, quibus cum propter fidei caritatem continenter bellum gerit, opidis vestris receptos et omni re juvatos extitisse”, J. Radonić, *Djuradj Kastriot Skenderbeg ...*, f. 39.

³⁹ *Po aty*, f. 63.

Kështu, përtej problemit të pagesës së 1400 dukatëve, marrëveshja e vitit 1448 tregoi kufizimet e saj edhe në problemet më therëse, ato që kishin të bënin me luftën dhe paqen. Nuk ka dyshim, se Skënderbeu e konsideroi arritjen e asaj marrëveshjeje edhe si fillimin e një aleance me Republikën në qëndresën kundër turqve osmanë. Në këtë vështrim, në shkurt 1454, Skënderbeu e ftoi Senatin që “të udhëzonte të gjithë qeveritarët venecianë në Shqipëri, që të bashkëpunojnë me të...dhe duke u grumbulluar rreth tij të gjithë forcat tona, bashkë me forcat e tij e të zotërve të tjerë të Shqipërisë, me ndihmën e Zotit, të mund t’i bëhet ballë furisë së Turkut”⁴⁰. “Gjithkush e kupton”, vazhdonte më tej arsyetimin e tij Skënderbeu, “se nuk ka mënyrë më e mirë e më të sigurtë për të ruajtur zotërimet e Sinjorisë në Shqipëri, se sa të urdhëroheshin qeveritarët venecianë të binin në marrëveshje me Skënderbeun, në mënyrë që të gjithë njerzit e të gjitha forcat e Shqipërisë të bashkoheshin në një të vetme përballë Turkut”⁴¹.

Në fakt, situata atë prag pranvere ishte shumë kritike. Nga një letër e posaçme e Skënderbeut, por edhe nga raportet e qeveritarëve venecianë në Shqipëri si dhe “nëpërmjet shumë rrugëve të tjera”, Senati ishte njoftuar se turqit përgatiteshin të sulmonin atë verë me synim “që ta hiqnin qafe Skënderbeun dhe njëherësh të pushtonin të gjitha zotërimet veneciane në Shqipëri” (*ad destructionem dicti Scandarbegi et ad accipiendum omnes terras et loca nostra Albanie*)⁴². Skënderbeu, me mprehtësinë e tij prej strategu e politikani e kishte parë drejt, kur i ishte drejtuar Senatit për një ndryshim thelbësor në marrëdhëniet e tyre. Dukej rasti i përshtatshëm për të filluar një aleancë ushtarake me Sinjorinë. Në fakt, në një moment të parë Senati gjykoi pozitivisht, dhe i udhëzoi qeveritarët venecianë në Shqipëri që t’i përgjigjeshin ftesës së Skënderbeut e të mblidheshin me të në vendin që ai do caktonte, përveç qytetit të Shkodrës (*excepta civitate Scutari*). Përfaqësuesit venecianë

⁴⁰ “*et ipse Scandarbegus requirat, velimus mandare omnibus Rectoribus nostris partium illarum, quod cum sua Magnificentia subito taliter se intelligant...et coadunatis apud se omnibus viribus nostris, suis et aliorum dominorum Albaniae, possit auctore Deo, resistere impetui dicti Teucris*”, *Po aty*, f. 43.

⁴¹ “*Et sicut omnes intelligunt conservationi status nostri in Albania, nulla alia securior, neque melior provisio fieri possit, quam ordinare, quod nostri rectores talem intelligentiam capiant cum dicto Scanderbego. Quod omnes gentes et vires Albanie colligantur in unum ad appositum dicti Teucris*”, *Po aty*.

⁴² *Po aty*, f. 43.

mandatoheshin “për të biseduar e për të vendosur mbi mjetet dhe mënyrat që duheshin përdorur për t’i rezistuar Turkut dhe për të shpëtuar tokat e banorët e asaj treve”. Venecianët autorizoheshin, gjithashtu, të lidhnin marrëveshje me Skënderbeun e me zotërit e tjerë të Shqipërisë “në mënyrë që të gjitha forcat e atij vendi të bashkoheshin kundër Turkut”⁴³.

Por vetëm disa muaj më vonë, më 31 dhjetor 1454, Senati i dërgonte një udhëzim qeveritarëve të vet në Shqipëri, që shkonte në të kundërtën e këtij bashkëpunimi të kërkuar nga Skënderbeu dhe në parim të pranuar nga Sinjoria. Teksti i tij thotë shprehimisht: “T’i shkruhet Kontit të Shkodrës...që të ruajë paqen që kemi me Turkun dhe në luftimet që do të ndodhin mes Turqve dhe Skënderbeut, duhet të silllet në mënyrë të tillë, që kurrësesi të mos cenojë paqen që kemi me Turkun”⁴⁴.

Në këtë mënyrë merr kuptim letra që Kastrioti, nëpërmjet ambasadorit e njëherësh kryesekretarit të tij (protonoter), abatit Gjergj Pelini, i dërgoi Senatit të Venedikut përpara korrikut të vitit 1457. Teksti i plotë i saj, i ndarë sipas çështjeve, ruhet në përgjigjen e Senatit të datës 8 korrik 1457⁴⁵. Interesant është që në fillim të kapitullit të parë të letrës, është përfshirë edhe një porosi e veçantë e Skënderbeut për abat Pelinin, e cila na fut në frymën e jashtëzakonshme të kësaj letre: “Zoti protonoter, ju pas pak do udhëtoni për Venedik. Zoti ua bëftë rrugën e mbarë. Së pari do t’i kujtoni Sinjorisë së Venedikut çështjen e provizionit tim: nisur nga sasia dhe mënyra si po ma japin, më mirë të mos ma japin fare. Megjithatë, kërkojini Sinjorisë të më ndihmojë në çështjet e ngutshme duke më dhënë 2 mijë dukate nga provizionet e mia të prapambetura. Por kërkojani me shumë forcë”. Toni i ashpër i këtij preludi të letrës vazhdon edhe më tutje. Skënderbeu kërkonte që provizioni t’i jepej në të holla, dhe jo në sasi kripe, siç insistonte Sinjoria. Kjo mënyrë e fundit nuk

⁴³ “*et ex nunc sit captum quod mandetur omnibus nostris Rectoribus Albanie, quod his habitis, omnes convenire debeant in illo loco, qui comodior sit Scanderbego, excepta civitate Scutari, et cum sua Magnificentia conferre et deliberare de remediis et modis, cum quibus resistere possit dicto Teucro et salvare terras et animas illius provincie, capiendo talem intelligentiam cum dicto Scanderbego, et aliis dominis Albanie, quod omnes potentie illarum partium sint unite ad oppositum dicti Teucris*”, Po aty.

⁴⁴ “*Et ex nunc sit captum quod scribatur Comiti Scutari... quod servare debeat pacem quam habemus cum Teucro, et in novitatibus que sequerentur inter Teucros et Scandarbegum se habere debeant per modum, quod non contraveniant aliquantulum paci quam cum Teucro habemus*”, AAV, pars III, tom 23, nr. 6282, f. 341-2: 31 dhjetor 1454.

⁴⁵ J. Radonić, *Djuradji Kastriot Skenderbeg ...*, f. 84-86.

kishte funksionuar, sepse qeveritarët venecianë të Durrësit, Shkodrës e Lezhës që duhet ta lëvronin vlerën e provizionit në kripë, gjenin vazhdimisht pretekste për t'iu shmangur detyrimit. “Unë”, shpërthente Skënderbeu, “nuk mund ta duroj më këtë gjendje, sepse deri tani nga këta qeveritarë e proveditorë kam patur vetëm fjalë e asnjë vepër” (*perche mi non posso più durar a questo modo, perche mi ho abudo asay parole e pochi fati de questi rectori e dali proveditori*). Kësaj kërkesë me tone ultimative, Senati iu përgjigj me refrenin e përhershëm: do urdhërohej bajliu venecian i Korfuzit të dërgonte një sasi të madhe kripe në Shkodër e në Lezhë, me të cilën do shlyhej tërësisht provizioni i tij (*quod integraliter tota provisio sua erit soluta*). Vetë toni i ftohtë i përgjigjes, tregon se edhe këtë herë premtimi do të mbetej në letër. Kërkesa e dytë e Skënderbeut kishte të bënte me detyrimin e Sinjorisë, të fiksuar në marrëveshjen e vitit 1448, për t'i dhuruar Skënderbeut një sasi stofi të çmuar të mjaftueshme për të qepur dy kostume në vit. Skënderbeu ankohej se atij i dërgohej po ajo sasi që i dërgohej edhe zotërinjve të tjerë, 16 pash stof. Por siç duket, ajo nuk mjaftonte për trupin e tij, që ishte mbi normalen, dhe Senati vendosi që në vend të 16 pashë skarlati t'i dhuroheshin 18 të tilla. Senati miratoi gjithashtu edhe kërkesën tjetër të Skënderbeut, për të liruar nga detyrimet doganore mallrat e blera prej tij në zotërimet e Venedikut, privilegj që e kishte gëzuar edhe i ati i tij, Gjon Kastrioti. Toni i ashpër polemik i Skënderbeut shquhet edhe në kapitullin ku ai njofton se ka marrë vesh se venecianët po vepronin në kundërshtim me marrëveshjen e 1448-ës, duke i hequr Skënderbeut të drejtën që në rast rreziku të strehohej bashkë me familjarët e njerëzit e tij në zotërimet veneciane (*chomo hanno fato paxe comesso mi, e li capitoli confermadi se me vegnera alguna necesità a mi e ala mia fameia e a li mei homeni, che possano scampar in ogni logo dove vorano, e adesso ho inteso che hano fato altramente*). Sigurisht, me një takt të hollë prej diplomati, Skënderbeu bën fajtor për këtë “shkelje” qeveritarët venecianë në Shqipëri, jo vetë Sinjorinë. Kundrejt një mirësjelljeje të tillë, Senati nuk mund të vepronte ndryshe, veç ta siguronte Skënderbeun se kapitulli i marrëveshjes ishte ende në fuqi dhe se ai, bashkë me njerëzit e vet, mund të strehohej në çdo moment në zotërimet e Venedikut. Por, Sinjoria nuk deshi të lëshojë fare në kërkesën tjetër të Skënderbeut, që kishte të bënte me dëshirën e tij për t'u hedhur në Mal të Zi e më sipër, në territoret që kishin qenë të despotit Gjergj Brankoviç e që tani mbaheshin nga turqit. Përsëri kemi një Skënderbe të ashpër, që ndonëse kërkon lejen e

Venedikut për të kryer këtë inkursion, nuk ngurron të thotë se preferonte të kalonte në Mal të Zi me miratimin e Sinjorisë, por edhe pa këtë ai do të dinte si të vepronte, duke lënë qartazi të hapur përdorimin e dhunës (*se me voleti dar a passar con la vostra benedicion , io passerò, e se non me darete, io providerò meglio che porò*). Kësaj kërkese të vështirë Senati iu përgjigj butazi se “nuk mund t’ia lejojmë Zotërisë suaj kalimin në Mal të Zi, pasi kështu do i jepej shkak turqve që të vijnë me ushtri kundër nesh e kundër jush” (*quod si Magnificentie sue concederemus transitum in Xentam, daremus materiam Turcho veniendi cum exercitu contra nos et ipsum*). Me sa duket, Sinjoria kishte një farë arsye pse i trembej depërtimit të Skënderbeut në veri të Shkodrës. Një vit më vonë, më 14 prill 1458, ambasadori venecian në Napoli informonte “mbi qëllimet e mbrapshta të Skënderbeut kundrejt zotërimit tonë” si edhe për “planin e tij për të pushtuar Drishtin e Tivarin, me marrjen e të cilëve shpreson se do e ketë të thjeshtë të shtjerë në dorë edhe Shkodrën e të gjitha zotërimet tona në Shqipëri” (*de pessima intentione Scandarbeg contra dominium nostrum...et de intentione dicti Scandarbegi accipiendi Drivastum et Antibarum: quibus habitis, sperat facile posse obtinere Scutarum et omnia alia nostra Albanie*)⁴⁶.

Megjithatë, në muajin gusht 1458, diçka kishte ndryshuar në marrëdhëniet e Skënderbeut me Venedikun, ose të paktën me përfaqësuesit e tij në Shqipëri. Ndërkohë, Lekë Dukagjini u kishte rrëmbyer venecianëve Danjën, e pak më vonë edhe Shatin me kështjellën e tij⁴⁷. Kësaj radhe Venecianët nuk preferuan të kërkonin ndihmën e turqve kundër Dukagjinit: në fakt Leka ishte lidhur me turqit, edhe pse, sipas Sinjorisë, “prej Turqve ai nuk kishte patur e nuk mund të kishte as në të ardhmen ndonjë ndihmë apo favor” (*siche cum verità da i Turchi el non havesse ni podesse haver socorso, over favor alguno*)⁴⁸. Në të kundërtën, iu drejtuan Skënderbeut, që me dukagjinët ishte prej kohësh në një konflikt të ashpër. Atë kohë, Skënderbeu e quante Lekë Dukagjinin “armik të Krishtit dhe timin” (*inimigo de christo et mio*)⁴⁹. Ndërkohë edhe profili i Skënderbeut në arenën ndërkombëtare ishte rritur. Në përgjigjen e 8 shkurtit 1458 që papa Kalisti III i dërgonte një

⁴⁶ AAV, pars III, tom 23, nr. 6637, f. 312.

⁴⁷ AAV, pars III, tom 23, nr. 6677, f. 343; AAV, pars III, tom 24, nr. 6784, f. 33: 7 maj 1459.

⁴⁸ AAV, pars III, tom 23, nr. 6677, f. 345.

⁴⁹ AAV, pars III, tom 24, nr. 6792, f. 38-9: 4 qershor 1459.

letre të mëparshme të Mbretit Alfons të Napolit, ku ky i rekomandonte Skënderbeun, papa Kalisti III shprehej me këto fjalë për Kastriotin të cilin ai e prezanton si *zot të Shqipërisë*: “Për këto trimëri dhe bëma të jashtëzakonshme, ai meriton shumë jo vetëm nga ne, por nga e gjithë bota e krishterë, dhe për këtë ne do të donim ta përqaфонim shumë fort. Sepse po konstatojmë se si ai, pothuaj i vetëm, po e përballon tërbimin turk sikur të ishte një mur i pakapërcyeshëm që u ka mbyllur atyre çdo shteg për t’u derdhur në botën e krishterë; dhe ne i dimë mirë se ai dhe shtetasit e tij e kanë paguar këtë me sakrificat të panumurta”⁵⁰.

Venediku nuk mund të injoronte këto vlerësime që vinin nga kreu i kishës katolike e të vijonte në armiqësinë e paprinciptë me Skënderbeun e në miqësinë e pamoralshme me turqit osmanë. Kështu, përplasja e Lek Dukagjinit me Venedikun për çështjen e zotërimit të Danjës e rrethinave të saj, u bë shkak për të afruar dy armiqtë e dikurshëm, që ishin edhe armiq të tij. Më 16 gusht 1458 midis Skënderbeut dhe Kont-Kapitenit venecian të Shkodrës u arrit një marrëveshje, teksti i së cilës iu paraqit Senatit nga ambasadori i Skënderbeut, Gjergj Pelini. Senati nuk u druajt ta quajë atë që në fillim “marrëveshje kundër Lek Dukagjinit”. Senati diskutoi gjatë për përmbajtjen kapitullit të dytë të marrëveshjes së akorduar midis Skënderbeut e përfaqësuesit të tij, duke i sjellë atij një ndryshim domethënës: “Mendojmë, që për të hyrë ne në këtë marrëveshje me zotin Skënderbej, do ishte me vend dhe arsye të thuhej, qëkur të jetë fjala për luftë, të dy palët të luftojnë së bashku dhe njera mos të tërhiqet e ta lerë palën tjetër të vazhdojë e vetme luftën. Kur të jetë rasti, të dyja palët do marrin pjesë në bisedimet për paqe, por Sinjoria jonë duhet të jetë e lirë ta nënshkruajë paqen edhe e vetme”⁵¹. Në këtë klauzolë të

⁵⁰ *Intelleximus, quanta affectione dielectum filium nobilem virum Scanderbech Albanie dominum nobis commendaris, quod nobis fuit jucundissimum; tametsi nostra propria voluntas illum pro suis virtutibus et ingentibus factis, quibus non solum de nobis, sed de universa Christianitaten optime meretur, arctiori, quam dici possit, charitate complectamur; videmus enim eum prope solum furori saevissimorum Turcorum quasi murum quemdam firmissimum esse oppositum, qui ipsorum aditum precludit, ne in Christianitatem irrumpant: nec nos latet, quot cladibus ipse cum suis subditis affectus fuerit*”, Daniele Farlati, *Illyricum Sacrum*, vol. VII, Venezia: Jacopo Coletti, 1817, f. 422.

⁵¹ “*Dixemo che intrando nui in questa intelligentia cum el prefato Signor Scanderbego ne pare conveniente et raxonevole che la guerra se fazi per intrambe le parte comunamente, et una non se retraze et laltra proseguisca sola in essa guerra. Et quando loccorrera che comunemente se trati e pratici de la paxe, sia in libertà de la*

fundit të shtuar nga Senati, gjendet e shkruar në letër një praktikë, që Republika e zbatoi shpeshherë, ajo e braktisjes së aleatëve dhe e nënshkrimit të paqeve të njëanshme⁵². Gjithsesi, aleanca e Skënderbeut me Republikën kundër Lek Dukagjinit funksionoi për pak kohë. Ishte në fuqi akoma në qershor 1459, kur mësohet se Skënderbeu kishte dëbuar Lekën dhe kishte pushtuar “malin e Shatit” me disa fshatra përreth, që, pas insistimit të Sinjorisë ua ktheu Venecianëve⁵³.

Por, në fillim të vitit 1462 marrëdhëniet me Republikën e Venedikut kishin hyrë përsëri në krizë. Sipas venecianëve, Skënderbeu “kishte marrë qëndrim armiqësor, pasi pretendonte gjëra që ne nuk i pëlqejmë” (*intelleximus animum suum erga res nostras illius provincie male dispositum esse. Et pretendit idem Scanderbegus aliquas causas qui multum displicent nobis*)⁵⁴. Megjithatë, kësaj radhe Sinjoria ishte e vendosur t’i zgjidhte paqësisht punët me zotin e Shqipërisë. Ky konsiderohej ndër prijësit kryesorë të kryqëzatës së madhe antiosmane që papa Piu II po përgatiste kundër Mehmetit II, ku më në fund edhe Venediku po dukej se do merrte pjesë⁵⁵. Madje, Republika shfaqet në radhët e propagandistëve më të vendosur të kryqëzatës antiosmane. Më 22 janar 1462 Senati e nxiste Luigjin XI të Francës të mos humbte kohë duke planifikuar kryqëzata personale nga Italia në Shqipëri, por t’i bashkohej përpjekjeve të përbashkëta të koordinuara nga Papa. “Përndryshe”, “arsyetonte Sinjoria, “ka të ngjarë që, ndërsa Madhëria Juaj planifikon të hidhet me ushtri nga Brindizi në Durrës, Turku do ketë hedhur ushtritë nga Vlora në Brindizi, gjë të cilën është mburrur se do ta bëjë, siç na e ka deklaruar edhe vetë neve”⁵⁶. Tashmë, në vlerësimin

nostra Signoria sola venir in la dita paxe. Et in questo effecto sia reformato dicto capitulo”. AAV, pars III, tom 23, nr. 6676, f. 342: 16 gusht 1458.

⁵² “*mà il detto Turco fando poi pace con Venetiani, quando li donaro Scutari, non me volsero comprendere in quella, com’hò detto, ansi promisero in lor mano venisse*”, G. Musachi, *Breve Memoria ...*, f. 276; Peter Bartl, *Der Westbalkan zwischen spanischer Monarchie und osmanischem Reich*, Wiesbaden: Otto Harrassowitz, 1974, f. 218.

⁵³ AAV, pars III, tom 24, nr. 6792, f. 38-9: 4 qershor 1459.

⁵⁴ AAV, pars III, tom 24, nr. 7132, f. 382-3: 6 prill 1462.

⁵⁵ F. S. Noli, *Gjergj Kastriot Skënderbeu ...*, f. 328.

⁵⁶ “*quod si forte accideret, quod Deus advertat, quod data esset Turcho facilitas penetrandi in eam partem, quam vellet, in viscera christianorum, et ubi Serenitas Sua dicit de transeundo ex Brundisio Dirachium, forsitan Turchus ante transitum facere posset ex Avalona Brundisium, quem admodum jam sibi spondet et gloriatur se facere vellet et sicuti etiam dici nobis fecit*”, J. Radonić, *Djuradj Kastriot Skenderbeg ...*, f. 129.

strategjik të Venedikut, Shqipëria e Skënderbeut nuk ishte më një pengesë për planet e Republikës, por ishte vija e parë e frontit për mbarë botën e krishterë. Ishte Senati venecian ai që shfaqej në rolin e mbrojtjes së kauzës shqiptare deri edhe përpara aleatëve historikë të Skënderbeut, Papës së Romës dhe Mbretit të Napolit. “Duhet patur parasysh, se shkatërrimi dhe fundi i Shqipërisë është edhe shkatërrimi e fundi i Italisë dhe i gjithë botës së krishterë”, i deklaronte Papës Pali II, më 7 qershor 1466, i dërguari venecian, ndërsa këmbëngulte që Skënderbeut t’i dërgoheshin pa humbur kohë ndihmat e duhura (*certissimum teneri debet quod non solum concernunt ruinam et escidium Albanie, verum Italie et christianitatis nisi tanto furori validis et celerrimis provisionibus occuratur*)⁵⁷. Po atë kohë, Senati ngrinte të njëjtin shqetësim tek Mbretit Ferrante i Napolit, duke deklaruar me dëshpërim, se “gjendja e të Madhërismit Skënderbeg dhe e Shqipërisë, për pasojë edhe e gjithë botës së krishterë, ndodhet në rrezikun më të madh” (*quod cum Magnificus Scandarbegus et res Albanie et per consequens christianitatisin maximo periculo constitute sint*)⁵⁸.

Në kushte të tilla, Republika e Venedikut gjykonte se mosmarrëveshjet, që vazhdonte të kishte me Skënderbeun, “duhet të zgjidheshin paqësisht” (*ut res pacifice transeant*)⁵⁹.

Kështu u arrit në marrëveshjen e dytë të madhe, pas asaj të vitit 1448, midis Gjergj Kastriotit dhe Republikës së Venedikut. Me mprehtësinë e tij të zakonshme dhe vështrimin gjithëpërfshirës, F. Noli hedh idenë se kjo marrëveshje u pranua me ngut nga Venediku nën shqetësimin e paqes së nënshkruar më 27 prill 1463 mes Skënderbeut dhe sulltan Mehmetit II. Madje, sipas tij, kjo paqe u lidh enkas nga Skënderbeu për të detyruar Venedikun [madje, gjithë shtetet e krishtera, do të shtonim ne] të hiqte dorë nga hezitimet dhe të bashkohej në luftën e vendosur kundër osmanëve⁶⁰. Në fakt, më 20 gusht 1463, në emër të Skënderbeut, i përhershmi abati Gjergj Pelini dhe Andrea Smaqi nënshkruan në Venedik kapitujt e marrëveshjes së re, që ndryshe nga ajo e vitit 1448, ishte një pakt aleance ushtarake kundër Perandorisë Osmane. Projekti i marrëveshjes i hartuar nga Skënderbeu, që e emërtonte atë

⁵⁷ Oliver J. Schmitt, “Actes inédits concernant Venise, ses possessions albanaises et ses relations avec Skanderbeg entre 1464 et 1468”, në *Turcica*, 31, 1999, f. 277.

⁵⁸ O. J. Schmitt, “Actes inédits concernant Venise ...”, f. 279.

⁵⁹ AAV, pars III, tom 24, nr. 7132, f. 382-3: 6 prill 1462.

⁶⁰ F. S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu ...*, f. 325-326.

“marrëveshje për të luftuar kundër turqve në mbrojtje të zotërimeve të Venedikut e të zotërimeve të Skënderbeut”, përmbante 6 kapituj. Në të parin kërkohet që Republika e Venedikut të vinte në dispozicion të Skënderbeut një numër ushtarësh e kalorësish italianë, aq sa ta gjykonte të përshtatshme Sinjoria. “Por kjo duhet të ndodhte shumë shpejt, për shkak të rreziqeve të pritshme” (*el qual favor vol essere presto per i casi puol occorrer*). Së dyti, Skënderbeu kërkonte që provizioni i tij problematik, tash e tutje t’i paguhej drejtpërdrejt nga Sinjoria, e jo nga qeveritarët e saj në Shqipëri, për të shmangur konfliktet që ishin konstatuar në të kaluarën (*accio non nassa scandolo tra loro, come per el passato*). Së treti, çdo vit, nga muaji prill e deri në qershor kur turqit e kishin zakon të dërgonin ushtri për shkatërrimin e zotërimeve të Republikës e atyre të Skënderbeut, Sinjoria duhet të dërgonte një flotë të vogël në brigjet e Shqipërisë, ku në rast nevojë të mund të gjenin strehë Skënderbeu me njerëzit e tij, si dhe funksionarët venecianë. Së katërti, në rast se Venediku do bënte paqe me turqit, do përfshinte në të edhe Skënderbeun, njerëzit e zotërimit e tij. Së pesti, djali i Skënderbeut, atë kohë 8 vjeç, do të pranohej në gjirin e fisnikërisë veneciane. Së shtati, nëse Skënderbeu dëbohej nga vendi i tij, do t’i akordohet një tokë e një provizion i arsyeshëm, që të mund të jetojë “me shpresën e kthimit në shtetin e tij” (*expulso del suo paese li sia deputado qualche nostro luogo e terra cum la provision se convegni al Signor chel possi viver cum speranza de tornar in suo stado*). Së teti, gjatë qëndrimit si refugjat, do t’i shlyheshin të gjitha provizionet e prapambetura⁶¹.

Siç shihet, teksti përmban edhe kapituj të përcaktuar nga marrëveshja e vitit 1448. Të gjitha këto kërkesa u pranuan dhe u bënë pjesë e marrëveshjes. Përsa i përket pikës së parë, që ishte edhe më e rëndësishmja, Senati vendosi që të dërgonte dhe të vinte nën urdhrat e Kastriotit, 500 këmbësorë e 500 kalorës. Djali i Skënderbeut do të mbante titullin e Kapitenit të kësaj trupe, kurse vetë Skënderbeu atë të guvernatorit⁶².

Marrëveshja, në dukje, realizonte atë çka Skënderbeu ia kishte propozuar Republikës qysh në vitin 1454, kur kishte kërkuar bashkimin e forcave shqiptare e veneciane në luftë kundër rrezikut osman. Sidoqoftë, Venediku u përpoq ta shiste marrëveshjen me Skënderbeun si

⁶¹ AAV, pars III, tom 24, nr. 7449, f. 186-7: 20 gusht 1463.

⁶² Po aty.

fitoren e vet. Më 9 shtator 1463 Senati i përcillte Papës Piu II lajmin e nënshkrimit të marrëveshjes dhe nënvizonte se “me anë të marrëveshjes së arritur me zotin Skënderbej, shpresojmë ta kemi shkëputur atë nga paqja me Turkun” (*per la pratica auta cum el S. Scanderbego speremo averlo retracto da la pase a favor del Turco*). Kështu, Skënderbeu “do jetë i lirë të veprojë duke i bërë luftë serioze armikut tonë e do mund ta dëbojë atë nga Evropa” (*el se potra operar non solo poder inferir degna guerra al inimico nostro et caçarlo de l'Europa*)⁶³. Më konkretisht, venecianët besonin se e kishin shkëputur Skënderbeun nga paqja me turqit dhe e kishin vënë në shërbim të kauzës së krishterë, me anë të premtimit se do i dërgonin përforcime me ushtarë italianë (*cum suma diligentia et opera se avemo forzadi ritrarlo de quella pase e speremo averlo reducto al favor de le cosse christiane mediante la promessa de conveniente soccorso de zente italiane*)⁶⁴. “Nëse Skënderbeut i jepen ndihma në ushtarë, për të cilat ka nevojë, ai do luftojë trimërisht kundër armikut të përbashkët: sa më shumë ndihma t’i jepen, aq më shumë e aq më mirë ai do jetë i dobishëm, sepse duke u shtuar atyre edhe forcat e veta, Skënderbeu do mund ta përballojë më mirë armikun e, madje, do mund ta zmadhojë shtetin e vet”⁶⁵. Por, përtej interesave të kryqëzatës dhe atyre të vetë Skënderbeut, Republika e Venedikut shihte interesat e veta, të cilat tashmë i shihte të lidhura me ato të heroit shqiptar. Më 17 tetor 1463, dogji i Venedikut, Cristiano Mauro, dërgoi me mision tek Skënderbeu proveditorin Gabriel Trevisan, i cili duhet ta siguronte bashkëbiseduesin për mbështetjen veneciane në favor “të ruajtjes dhe zgjerimit të shtetit të tij...si dhe të mbrojtjes e të ruajtjes së zotërimeve tona” (*pro conservacione et auctione status sui...et etiam pro defensione et conservacione nostri*)⁶⁶.

⁶³ AAV, pars III, tom 24, nr. 7475, f. 208: 9 shtator 1463.

⁶⁴ AAV, pars III, tom 24, nr. 7488, f. 226: 18 shtator 1463.

⁶⁵ AAV, pars III, tom 24, nr. 7489, f. 228: 18 shtator 1463: “*Et si prestabuntur sibi favores gentium ut valde necessarium est, tenemus quod magnanime faciet contra comunem hostem, sperandum que erit per operam suam et favorem predictorum multa bona confici posse quantumque maiores favores ei prestabuntur iudicio nostro, tanto melius tantoque utilius erit, quoniam cumulatis etiam viribus suis hostem poterit offendere et statum suum ampliare*”.

⁶⁶ AAV, pars III, tom 24, nr. 7540, f. 272-3: 17 tetor 1463.

Si provë e fundit e qëndrimit të ri të Venedikut ndaj Gjergj Kastriotit, do vlente edhe përpjekja, e paprecedentë në marrëdhëniet e tij me Skënderbeun, për të shuar mosmarrëveshjet mes krerëve shqiptarë dhe për t'i bashkuar ata nën urdhrat e tij. Kështu, më 17 tetor 1463, Senati porosiste të dërguarit e vet që të pajtonin e të bashkonin me zotin e Shqipërisë krerë të tillë si Aleks Spani, mik i Sinjorisë, apo deri edhe Lek Dukagjinin, armik i betuar i saj dhe i vetë Skënderbeut. “Rivendosja e paqes dhe e miqësisë mes tyre, do t'i vlente shumë kryqëzatës së krishterë”, arsyetonte Sinjoria⁶⁷.

Megjithatë, nëse gjykojmë nga burime direkte e indirekte, hidhësia në marrëdhëniet midis Venedikut e Skënderbeut vazhdoi edhe më tej. Sinjoria nuk ishte plotësisht e sinqertë kur deklaronte botërisht frymën e saj antiosmane dhe mbështetjen për kryqëzatën e krishterë. Nuk ishte e sigurt as kur pretendonte se do të shkëpuste heroin shqiptar nga paqja që kishte nënshkruar me sulltan Mehmetin II, më 1463. Pak më vonë, në vitin 1466, ajo kishte nisur traktativat për t'u marrë vesh me osmanët. “Për prirjen tonë të natyrshme, ne nuk jemi në gjendje ta refuzojmë paqen”, kishte deklaruar me atë rast Senati i Venedikut (*ex naturali inclinatione nostra nesciremus recusare pacem*)⁶⁸. Pikërisht me atë rast mësohet për një ndërhyrje të Skënderbeut për ta bindur Sinjorinë të hiqte dorë nga ky qëndrim. Në përgjigjen që i jepte Skënderbeut lidhur me këtë çështje, më 18 mars 1466, Senati nënvizonte: “Për sa na shkruani lidhur me bisedimet tona për paqe me Turkun, ju sigurojmë se ne i njohim shumë mirë dredhitë e tyre ... Megjithatë, ju falenderojmë për këshillat dhe mendimin tuaj, të cilat do t'i kemi mirë parasysht” (*de quanto vui ne scriveti de la pratica de la pace cum el Turco, ve certificamo, che le astutie del Turcho a nui sono notissime...Ringratciemovi niente manco de lo avizo datoci e de la dechiarita vostra opinione, de la qual ne faciamo digna existimation*)⁶⁹. Ka të ngjarë, që me rastin e atyre

⁶⁷ “quia illis partibus sunt nonnulli domini, partim nostro dominio commendati, partim qui erga statum nostrum bonam voluntatem habere videntur, sicuti literis Comititis et Capitanei Scutari de Alexio Spano, nuper certiores facti sumus...Et quoniam intelligimus Magnificum Lecham Duchaynum multum expeditioni christiane conferre posse si in amicitiam et pacem cum Magn. Scanderbego deduci posset, volumus tibi que mandamus, ut cum tuo studio curare debeas eos in concordiam et pacem deducere”, AAV, pars III, tom 24, nr. 7540, f. 272-3: 17 tetor 1463.

⁶⁸ J. Radonić, *Djuradj Kastriot Skenderbeg ...*, f. 170: Venedik 3 korrik 1465.

⁶⁹ *Po aty*, f. 180.

bisedimeve Skënderbeu të ketë dyshuar që Venediku mund t'u falte turqve edhe ndonjë zotërim të vetin në Shqipëri, për shembull Shkodrën (e cila, në fakt, iu dorëzua turqve pas dhjetë vjetësh). Një gjë e tillë do të shënonte edhe fundin e shtetit të tij, prandaj përpara 28 korrikut 1467, Kastrioti i dërgoi një letër Senatit, ku i kujtonte se “mbrojtja e Krujës dhe e Shkodrës është vendimtare për shpëtimin e dy shteteve tona”⁷⁰. Sigurisht, edhe në këtë rast, Sinjoria u përgjigj “me mirësjellje”, se e kishte parasysh një gjë të tillë. Ndërkohë, duket se ajo kujdesej të përhapte një tis dyshimi ndaj heroit shqiptar në oborret e Evropës. Më 31 korrik 1464, oratori i Milanos në Venedik raportonte se kishte dëgjuar një senator venecian të deklaronte se: “Ne nuk i zëmë aspak besë atij (Skënderbeut-P. Xh), sepse është shqiptar, tradhtar e i rrezikshëm; ai ka zgjedhur të mbajë një këmbë në dy këpucë: kur ta shohë se të krishterët janë të fuqishëm, do hidhet në krahun tonë, përndryshe do bjerë në ujdi me Turkun” (*Nuy non si fidamo di luy per niente, perche è Albanese et è traditore et tristo; luy ha facto un pensiero de tenere uno pede in doe scarpe. Sel vederà che li Christiani siano possenti, tenerà da nuy, altramente serà d'acordio cum lo Turcho*)⁷¹. Por ky vlerësim do t'i përshtatej më së miri pikërisht Republikës së Venedikut, e jo Skënderbeut, të cilit të gjithë i njihnin qëndrimin e patundur ndaj osmanëve. Nga ana e tij, ky kishte të gjitha arsyet të dyshonte në ndershmërinë e qëndrimeve të Sinjorisë. Edhe në dy vitet e fundit të rezistencës së tij, Skënderbeu dyshoi se Venediku përpiqej të shfrytëzonte situatën konfuze të shkaktuar nga prania e vazhdueshme e trupave osmane në Shqipëri për të rrëmbyer territore të tij. Sipas dëshmisë të ambasadorit të Milanos tek Papa, gjatë qëndrimit të tij të gjatë në Romë, në dimrin e vitit 1466-1467, kur nuk po gjente tek Papa Pali II gatishmërinë për ta ndihmuar, Skënderbeu bëri fajtor për këtë qëndrim refuzues të kreut të kishës përfaqësuesin venecian në oborin papnor. Ky i paskësh mbushur mendjen papa Palit II, se nuk qe e nevojshme të shpenzohej për të ndihmuar Krujën, pasi Sinjoria e kishte marrë përsipër mbrojtjen e saj dhe për ruajtjen e kështjellës kishte dërguar aty këmbësorë e forca të tjera. Dhe, sipas Skënderbeut, kjo ishte arsyeja përse

⁷⁰ S. Ljubić, *Listine o odnošajih ...*, vol. X, f. 395-396; F. S. Noli, *Histori e Gjergj Kastriot Skënderbeut ...*, f. 439.

⁷¹ J. Radonić, *Djuradaj Kastriot Skenderbeg ...*, f. 159: Oratori i Milanos nga Venediku, 31 korrik 1464:

Papa nuk po e vinte ujin në zjarr, ndërkohë që Sinjoria synonte ta përvetësonte atë kështjellë⁷².

Nuk mund të thuhet me siguri nëse këto zëra mbi Skënderbeun, që qarkullonin me shumicë në mjediset diplomatike të Romës, Napolit, Venecies apo Milanos, pasqyronin të vërtetën, apo ishin produkt i “luftës së dizinformimit” që zhvillohej në ato mjedise. Në fakt, ndryshe nga çfarë pretendonin emisarët venecianë, ndihma e Venedikut për operacionet tokësore e mbrojtjen e kështjellave në Shqipëri, që ishin ato për të cilat Skënderbeu kishte më shumë nevojë, ishte e papërfillshme⁷³. Madje, edhe ndihma me një mijë ushtarë që Venediku premtoi t’i vërë në dispozicion Skënderbeut me rastin e marrëveshjes së gushtit 1463, nuk iu dërgua ndonjëherë e plotë. Gjithmonë sipas raporteve të ambasadorëve të huaj, gjatë vizitës së tij në Romë në dimrin e vitit 1466-1467, Skënderbeu u ankua tek Papa për këtë çështje. I deklaroi atij se venecianët “nuk i kishin dërguar veçse pjesë-pjesë, njëherë 30 këmbësorë, herën tjetër 60 e më vonë 50, dhe e njëjta histori kishte ndodhur edhe me kalorësit. Kështu, gjithsej nuk kishte patur kurrë më shumë se 200 kalorës e po aq këmbësorë. Dhe një gjë të tillë, venecianët e bënë për ta çfilitur e ligështuar pak nga pak, në mënyrë që ai të katandisej aq keq, sa të detyrohej t’iu dorëzonte Krujën, që ata e dëshironin shumë. Por, siç thotë, ai e kishte kuptuar mirë një lojë të tillë, dhe prandaj ishte një mijë herë i gatshëm që më mirë të digjte gjithçka dhe t’ia lëshonte qytetin turqve, se sa atyre⁷⁴”.

⁷² “Scanderbecho ancora sta qui quasi desperato con poca speranza de haver soccorso dal papa per lo facto de Croya et de Albania, ni de dinari ni d’altro. Et li pare essere tenuto in tempo, maxime perche intende che uno d. Paulo Contarino venetiano, che se trova qui, ha dissuaso et dissuade la Santità antelata, digando ch’el non è necessario faccia altra spesa per lo soccorso de Croya, imperochè la Signoria de Venetia l’ha tolta in protectione et ben la farà guardare et dentro li sono soy fanti et altra gente. Et per questo non ne pare il papa curarse troppo. Et epso Scanderbecho chiaramente comprehendente la intentione de quella Signoria tendere a sottomettere quella terra, ma più presto dice la darà con tutto lo resto al Turcho”, *Po aty*, f. 213: 24 janar 1467.

⁷³ F. Thiriet, “Quelques reflexions sur la politique vénitienne à l’égard de Georges Skanderberg”, në *Deuxième Conférence des Etudes Albanologiques*, Tirana, 12-18 janvier 1968, vol I, Tirana: Université de Tirana, 1969, f. 75.

⁷⁴ “Insuper se dole molto largamente epso Scanderbecho de Venetiani, et ne dice ogni male, perche non gli hanno atteso cosi gli havesseno promisso; nam dice gli dovevano mantenere cinquecento cavali et cinquecento fanti, con li quali se seria pure andato tegnando et temporezando in modo chel non se seria reducto a cosi mal

S u m m a r y

VENICE AND SCANDERBEG, IN WAR AND PEACE

The friction in the relations of George Castrioti Scanderbeg with the Republic of Venice started because of the different viewpoints they had on the principal issue of the time – i.e., the attitude towards the ottoman Turks who threatened to penetrate deep into Europe. Scanderbeg believed that establishing a strong Albanian state and increasing its geopolitical importance by controlling Via Egnatia and the Strait of Otranto which could lead the ottomans to Europe, was crucial for the fight against the Turks. Actually it was his determination in fighting the Turks that brought him praise and reputation at home and abroad. The Republic of Venice, on the contrary, had had until then a history of special relations with the ottomans characterized by the tendency to come to terms and to avoid clashes with them. Although after 1463 it seemed as if Venice moved closer to Scanderbeg's attitude and that of the other western powers, the inclination for closer relations and peace with the Turks is obvious even after that date. Another reason that poisoned the relations between Scanderbeg and Venice came from the fact that by the time the Albanian hero returned to Albania and started his efforts to establish the Albanian state, the Republic had occupied and controlled the main Albanian towns, preventing him from making use of a necessary element for the development and international recognition of that state. Scanderbeg tried to free himself from the isolation that the Republic had forced him into by attempting to get Dania, Antivar, Drisht, Durres and Berat. However engaging in war in several fronts was not to his advantage in fighting the Venetians. The latter had their own reasons to remain distant, distrustful and hostile to Scanderbeg. His project to create a strong and unified Albanian state went against the interests of the Venetians who wanted to have to deal with small and weak Albanian provinces, in conflict and war with one another, thus easier to be controlled and influenced by the Republic. To this end, Venice worked mainly to weaken and undo the state structure that

termine como l'è, ma dice non gli hanno may mandato senon apoco, apoco, mo' XXX fanti, mo' LX, mo'L, et cosi de li cavali ancora; siche non ha mai habuto ducento cavali in tutto, ni altritanti fanti; et questo ha molto bene inteso, perche quella Sig.ia de Venetiani non lo faceva per altro, se non per farlo consumare et frustare apoco apoco, et redurlo a tale extremità, chel gli fusse forza dare ne le mane loro Croya, quale haveriano grande desiderio de havere... Verum dice havere molto bene inteso il tracto, et che più presto brusaria ogni cosa, et mille volte più tosto le daria al Turcho che a loro", A. Plasari, Skënderbeu. Një histori politike ..., f. 703.

Scanderbeg managed to build in the League of Lezha in 1444, by persuading and separating from Scanderbeg powerful noble families such as the Dukagjini, the Span, the Cernojevic, the Arianit, the Topia etc.